



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Ekonomi dhe Financë



RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 467/Pr. 14

Fushë-Arrëz, më 20.12.2024

Drejtuar: Këshilli Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 33 datë 26/11/2024, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2025-2027 dhe Buxhetin Vjetor per vitin 2025"

Analiza ligjore: Hartimi i projektit buxhetor afatmesëm 2025-2027 është bere bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin 68/2017 date 27.4.2017 " Per financat e veteqeverisjes vendore ", udhezimit të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë nr. 23 date 30.07.2018 "Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NJQV", udhezimit të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë "Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", dhe anekset plotësuese.

Hartimi i Buxhetit për vitet 2025 - 2027 është kryer pas një pune gjithëpërfshirëse te administratës se Bashkisë, anëtareve te Këshillit te Bashkisë , Njësise Administrative, komunitetin e biznesit, komunitetin e banoreve, si dhe aktore te ndryshëm te shoqërisë civile. Përgatitja e buxhetit është paraprirë nga dëgjesa dhe komunikim me publikun, Promovimi i transparencës në krijimin e instrumenteve financiarë ndaj komunitetit përbën një detyrim ligjor për organet shtetërore, por në fakt është edhe një detyrim moral që kane institucionet e qeverisjes vendore ndaj komunitetit qe përfaqësojnë. Hartimi i Buxhetit u përfshi në një cikël të plotë buxhetimi sipas kërkesave ligjore, duke i ndjekur te gjitha hapat te përcaktuara ne ligj. Administrata e Bashkisë është bazuar kryesisht ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe ligjin nr.146/2014 "Për konsultimin publik", përveç akteve ligjore dhe nënligjore teknike dhe specifike të sipërcituara të domosdoshëm për hartimin e këtij instrumenti financiar.

Situata aktuale e funksionit: Ky projekt buxhet është një instrument i rëndësishëm financiar që përveçse të promovojë transparencën, duhet të ketë një impakt të gjerë në Bashkinë Fushë Arrëz, duke përfaqësuar qoftë zonat urbane, qoftë zonat rurale që janë bashkuar në kuadër të reformës territoriale, si dhe të rikthejë mbrapsht në shërbime e investimeve të ardhurat e mbledhura nga komuniteti në formën e taksave dhe tarifave vendore. Planet e shpenzimeve për çdo program janë hartuar brenda burimeve që Bashkia ka në dispozicion (sipas kalendarit të miratuar më parë mbi përgatitjen e PBA). Ky dokument përdoret për të informuar Këshillin Vendor dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të Bashkisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisjes Vendore. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të Buxhetit Vjetor.

Situata financiare : Bashkia Fushë Arrëz ka ndjekur të gjithë fazat e hartirnin të buxhetit sipas afateve të përcaktuara në udhezimin perkates. Pas miratimit në keshill të tavaneve, kemi bere degjesat publike ne te gjitha njesite vendore qe mbulon bashkia sipas nje grafiku te përcaktuar.

Buxheti për vitin 2025 do të jetë në shumën 373.229 mijë lek.

Ka një rritje prej 20% të shpenzimeve për pagat e personelit (+ 55.332.880 lekë) për të reflektuar ndryshimet ligjore të vitit të fundit për rritjen e pagave të administratës. Numri i punonjësve do të pësojë një rritje të lehtë (+6 persona) vetëm tek arsimi për personelin mbështetës në shkollë. Në buxhetin e vitit të ardhshëm të gjithë shtesa punonjësve e parashikuar për shpenzimet e tyre do të mbulohen nga transferat nga të ardhurat që do sigurohen nga debitorët në vite.

Gjithashtu me fonde të trashëguara do planifikohen dhe shërbime e investime të cilat nuk janë realizuar në vitin 2024.

Bashkia do të kushtojë vëmendje të vecantë administrimit të pyjeve dhe kullotave duke qenë se pjesa më e madhe e territorit të bashkisë përbëhet prej pyjeve dhe kullotave. Bashkia e sheh si një burim që duhet shfrytëzuar dhe për këtë arsye ka vendosur të hartojë plane administrimi për ekonominë pyjore me një buxhet prej 3.700.000 lekë.

Bashkia do të vazhdojë bashkëpunimin me donatorë të ndryshëm dhe për këtë arsye ka planifikuar të shpenzojë 3.552.000 lekë.

Për tju përgjigjur nevojave në rritje për ndërhyrje në zonat rurale dhe emergjencave të ndryshme gjatë vitit Bashkia parashikon të blejë një fadrome me bashkefinancim 8.148.200 leke.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Financës ka relatuar përpara komisionit për Projekt Buxhetin 2025

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Financës ose Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Programi Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxheti Vjetor për vitin 2025 impakton jetën të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të bashkisë Pukë

A është objekt i konsultimit publik: Janë mbajtur dëgjuesat publike në Fushë Arrëz, në Njësitë Administrative Qafë Mali, Iballë, Fierzë dhe Blerim me banorët e të gjitha Njësitë

Administrative, Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit Komunitarë, përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit, etj.

Dëgjesat janë mbajtur sipas kalendarit të dëgjesave të publikuar në regjistrin e konsultimeve me publikun. Është publikuar edhe përmbledhja e rekomandimeve të qytetarëve.

Numri i pjesëmarrësve në konsultime ishte 108 persona, nga të cilët 32 gra dhe vajza (20%) dhe numri i rekomandimeve ishte 54.

Komisioni i Përhershëm për “Ekonomi dhe Financë”, i mbledhur me datën 20.12.2024, shqyrtoi projekt vendimit nr. 33 datë 26/11/2024, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetin Vjetor për vitin 2025” paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

FRANC DODA  Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Besjona Marku  Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë 20.12. 2024